

KËRKESË
Nr. 5275/4, datë 16.11.2015
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të “Rrjetit të Kanalizimeve të Vlorës, faza 2, IPA 2012”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me vendimit e Këshillit të Ministrave, nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Vlera totale e tokës “truall” është 198 570 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Eduart Seitaj

Lista e pasurive që shpronësohen nga zbatimi i projektit “Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve në Vlorë, faza 2, IPA 2012”

Nr	Stacioni pompimit	Nr.pas	zk	Indeksi hartes	pronaret	Lloji i pasurise	sip	Cmimi lek/m2
1	PS N4	45/23	8602	V1; AC-11	Irakli Cavo Evriniqi Stefa Vasilika Dushani Lefteri Gjyli	Toke truall	30m2	6 619 lek/m2
	Vlera totale							198 570 leke